



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për të siguruar aksesueshmërinë fizike në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

BASHKISË BELSH

Rruga “Haziz Dervishi”,
BELSH

BASHKISË BERAT

Rruga “Antipatrea”,
BERAT

BASHKISË BULQIZË

Lagjja “Minatori”,
BULQIZË

BASHKISË CËRRIK

Lagja Nr. 2, Rruga “Bulevardi Gjimnazi 1962”,
CËRRIK

BASHKISË DELVINË

Lagjja “Sinan Ballaci,” Rruga “Nazif Hadëri”,
DELVINË

BASHKISË DEVOLL

Lagjja Nr.1, Rr. “24 Tetori”, Nr. 9,
DEVOLL

BASHKISË DIBËR

Bulevardi Elez Isufi,
PESHKOPI

BASHKISË DIMAL

Rruga “Dimal”, Lagjja “18 Tetori”,
URA VAJGURORE

BASHKISË DIVJAKË

Pranë Sheshit “Santa Barbara”,
DIVJAKË

BASHKISË DROPULL

Jergucat,
GJIROKASTËR

BASHKISË DURRËS

Sheshi “Liria”, 2000,
DURRËS

BASHKISË ELBASAN

Rruga "Qemal Stafa",
ELBASAN

BASHKISË FIER

Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Rruga "Ramiz Aranitasi",
FIER

BASHKISË FINIQ

Finiq,
DELVINË

BASHKISË FUSHË-ARRËZ

Rruga Qendër,
FUSHË ARRËZ

BASHKISË GJIROKASTËR

Sheshi “Çerçiz Topulli”,
GJIROKASTËR

BASHKISË GRAMSH

Sheshi "Kamber Dermushi", Lagjja "Holta", Rruga "10 Korriku", Kati I,
GRAMSH

BASHKISË HAS

Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati Kulturës, "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë,
HAS

BASHKISË HIMARË

Spile,
HIMARË

BASHKISË KAMËZ

Bulevardi "BLU", Nr. 492,
KAMËZ

BASHKISË KAVAJË

Bulevardi "Josif Buda",
KAVAJË

BASHKISË KËLCYRË

Sheshi "Musa Fratari",
KËLCYRË

BASHKISË KLOS

Klos,
MAT

BASHKISË KOLONJË

Sheshi "Rilindja",
KOLONJË

BASHKISË KONISPOL

KONISPOL

BASHKISË KORÇË

Lagjja nr. 12, Bulevardi "Shën Gjergji", Kodi Postar 7001,
KORÇË

BASHKISË KRUJË

Sheshi “Skënderbej”,
QENDËR KRUJË

BASHKISË KUÇOVË

Blloku Nr.1, Lagja “Tafil Skendo”,
KUÇOVË

BASHKISË KUKËS

Sheshi “Skënderbej”, Lagjja 5,
KUKËS

BASHKISË KURBIN

Lagja Nr. 3,
LAÇ

BASHKISË LEZHË

Lagjja “Skënderbeg”, Sheshi “Gjergj Kastrioti”,
LEZHË

BASHKISË LIBOHOVË

Rruga “Avni Rustemi”,
LIBOHOVË

BASHKISË LIBRAZHD

Sheshi “Gjorg Golemi”,
LIBRAZHD

BASHKISË LUSHNJË

Lagjja "Kongresi i Lushnjes", 9001
LUSHNJË

BASHKISË MALËSI E MADHE

Koplik Qendër,
MALËSIA E MADHE

BASHKISË MALIQ

Bulevardi “Rinia”,
MALIQ

BASHKISË MALLAKASTËR

Lagjja “18 Prilli”,
BALLSH

BASHKISË MAT

Sheshi “Ahmet Zogu”,
BURREL

BASHKISË MEMALIAJ

Rruga “Tafil Buzi”, Godina Nr.7,
MEMALIAJ

BASHKISË MIRDITË

Rruga “Atë Gjergj Fishta”,
RRËSHEN

BASHKISË PATOS

Lagjja “Naftëtari”, Rruga “Unaza”,
PATOS

BASHKISË PEQIN

Bulevardi “Mustafa Gjinishi”,
PEQIN

BASHKISË PËRMET

Shëtitorja “Abdyl Frashëri”,
PËRMET

BASHKISË POGRADEÇ

Bulevardi “Rreshit Collaku”,
POGRADEÇ

BASHKISË POLIÇAN

Lagjja “Qendër” Poliçan, 5404,
POLIÇAN

BASHKISË PRRENJAS

Rruga “Skënderbej”,
PRRENJAS

BASHKISË PUKË

Sheshi “Tërbuni”,
PUKË

BASHKISË PUSTEC

Pustec,
KORÇË

BASHKISË ROSKOVEC

Lagja Nr. 1, Qendër,
ROSKOVEC

BASHKISË RROGOZHINË

Lagjja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori”,
RROGOZHINË

BASHKISË SARANDË

Rruga ”Abedin Dino”,
SARANDË

BASHKISË SELENICË

SELENICË

BASHKISË SHIJAK

Lagjja “Erzen”,
SHIJAK

BASHKISË SHKODËR

Rruga “13 Dhjetori”, Nr. 1,
SHKODËR

BASHKISË SKRAPAR

Lagjja “Çlirimi”, Rruga “Pasho Hysi”, Çorovodë,
SKRAPAR

BASHKISË TEPELENË

Rruga “Ali Pashë Tepelena”, Sheshi “Lord Bajron”,
TEPELENË

BASHKISË TIRANË
Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001,
TIRANË

BASHKISË TROPOJË
Sheshi “Azem Hajdari”, Bajram Curri,
TROPOJË

BASHKISË VAU I DEJËS
Rruga “Qafa e Gurit”,
VAU DEJËS

BASHKISË VLORË
Sheshi “4 Heronjtë”,
VLORË

BASHKISË VORË
Rruga “Unaza”, Nr. 73,
VORË

Për dijeni: **KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
Bulevardi “*Dëshmorët e Kombit*”, Nr. 4
TIRANË

PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bulevardi “*Dëshmorët e Kombit*”
TIRANË

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bulevardi “*Dëshmorët e Kombit*”
TIRANË

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
Rruga “*Ibrahim Rugova*”, Nr. 4
TIRANË

MINISTRIT TË SHETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
Bulevardi “*Dëshmorët e Kombit*”
TIRANË

Të nderuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, në kuadër të

- ✓ ushtrimit të atributëve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente...”;
- ✓ zbatimit të nenin 32, pika 1, germa “f”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili parashikon: “Komisioneri ka kompetencë të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”;
- ✓ Nxitjes së parimit të barazisë dhe ndalimin e çdo lloj diskriminimi,

parashtron këtë rekomandim për marrjen e masave për të siguruar aksesueshmërinë fizike në qendrat e votimit për personave me aftësi të kufizuar, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, si më poshtë:

I. Qëllimi i Rekomandimit.

Duke qenë se jemi në momentin para zgjedhjeve për Kuvend që do të mbahen më datë 11 Maj 2025 në Shqipëri, qëllimi i këtij rekomandimi është që njësitë e vetëqeverisjes vendore, si autoritetet përgjegjëse, të marrin masa për të siguruar aksesueshmërinë fizike në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuar, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij Komisioneri në disa raste ka konstatuar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për të ushtruar të drejtën e votës, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, për shkak të mungesës së aksesueshmërisë në qendrat e votimit¹.

Me qëllim marrjen e masave për të parandaluar situata të tilla diskriminuese për personat me aftësi të kufizuara në kuadër të ushtrimit të të drejtës së votës, të shkaktuara si pasojë e

¹ Vendimi nr. 142, datë 13.08.2021, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/08/Vendim-nr.-142-date-03.08.2021-S.L-kunder-KQZ-se-dhe-Bashkise-Tirane-Diskriminim.pdf>
Vendimi Nr. 41, datë 28.02.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/03/Vendim-nr.-41-date-28.02.2022-Fondacioni-Se-Bashku-kunder-Bashkise-Durres-Shijak-Kruje-dhe-ZQZ-Diskriminim-i-terthorte.pdf>.

mungesës së aksesueshmërisë në qendrat e votimit, Komisioneri ka rekomanduar² të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave të nevojshme për të garantuar elementët e aksesueshmërisë fizike dhe për të siguruar përshtatjen e arsyeshme në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për Zgjedhjet Vendore të datës 14 maj 2023.

Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), miratoi vëzhgimet përmblyëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të 503-të, të mbajtur më 16 shtator 2019³. Në lidhje me të drejtën e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike, Komiteti shprehet i shqetësuar për mungesën e aksesueshmërisë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në veçanti aksesueshmërinë e qendrave të votimit dhe materialeve të votimit, për personat me aftësi të kufizuara.⁴ KDPAK rekomandon marrjen e masave për të lejuar akses fizik të papenguar në votim, vendosjen e mekanizma të sigurt për të garantuar fshehtësinë e votimit dhe të sigurohet disponueshmëria e materialeve dhe informacioneve të tjera zgjedhore në formate të aksesueshme, duke përfshirë gjuhën e shenjave, *Braille* dhe leximin e thejshtë, në përputhje me Komentin e Përgjithshëm të Komitetit nr. 2⁵.

Në Raportin Përfundimtar të Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të datës 25 prill 2021, konstatohet nga vëzhguesit e OSBE/ODIHR-it se: *“Shumica e QV-ve të vizituara nuk ishin pa pengesa për personat me aftësi të kufizuara fizike.”*⁶

Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të datës 14 maj 2023⁷, konstatoi se: *“Rreth 60 për qind e qendrave të votimit të vëzhguara nuk ishin të aksesueshme në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara fizike, kurse në 28 për qind prej tyre, pozicionimi nuk ishte i përshtatshëm për zgjedhës të tillë⁸. Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet e tyre për të garantuar aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.”*

² Rekomandim Nr.29 Prot, datë 09.01.2023, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/05/Rekomandim-nr.-29-date-09.01.2023-Per-marrjen-e-masave-per-te-siguruar-aksesueshmerine-fizike-te-PAK-ne-qendrat-e-votimit-1.pdf>

³ Vëzhgimet Përmblyëse mbi raportin fillestar të Shqipërisë, miratuar në 2019, nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK), https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fALB%2fCO%2f1&Lang=en

⁴ Si më sipër, paragrafi 47.

⁵ Si më sipër, paragrafi 48.

⁶ Raporti Përfundimtar i Misionit të Kufizuar të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, varianti në gjuhën shqipe, faqe 28. Link: <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

⁷ Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të datës 14 maj 2023, varianti në gjuhën shqipe <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>

⁸ Në zonat rurale, përqindja e qendrave të votimit të vëzhguara që nuk ishin të aksesueshme në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara fizike ishte 68 për qind, krahasuar me 53 për qind në zonat urbane.

Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore të datës 14 maj 2023, ndër të tjera rekomandon: *“13. Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t’i përforcojnë përpjekjet për garantimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.”*

II. Legjislacioni dhe standardet e zbatueshme.

Personat me aftësi të kufizuara, si çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë kanë të drejtën të ushtrojnë në baza të barabarta me të tjetërt të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, si një e drejtë që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Neni 45, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon se : *“Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.4. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”*

Sipas nenit 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:

*“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”*

Në nenin 15, Kushtetuta sanksionon se, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin duke sanksionuar se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”*.

Neni 1, i Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, përcakton: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike,*

fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sipas Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi, përbën diskriminimin dhe është i ndaluar.

Në mënyrë të posaçme në nenin 9 “*Pjesëmarrja në politikë*”, të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, sanksionohet: “*Ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t’u zgjedhur dhe për t’u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.*”

Me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së “*Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*” (në vijim KDPAK). KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur.

Në nenin 29, KDPAK, njeh të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët, duke sanskionuar se:

“Shtetet palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër:

a) Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike mbi bazë të barabartë me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësi të kufizuara për të votuar dhe për t’u zgjedhur, ndër të tjera duke:

i) siguruar që procedurat, mjetet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të mundshme dhe të thjeshta për t’u kuptuar dhe përdorur;

ii) mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të votojnë me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse dhe të reja, kur të jetë e përshtatshme;

iii) garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistencë në votim nga një person që zgjidhet prej tyre, ”.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuara, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; b) informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe shërbimet e emergjencës. (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga Konventa si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”. Në nenin 3, pika 1, ky ligj përcakton se: “Aksesueshmëria” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se:

“ 3. “Pengesat” nënkupton:

a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;

b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal

është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar;

c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;

ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.”

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore:

a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme;

b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse;

c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3).

Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat, përfshin si ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike. (Kreu I, pika 4).

Kodi Zgjedhor, parashikon në nenin 108, të tij disa rregulla të veçanta për mënyrën e votimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Në nenin 108, pikat 6, 7 dhe 8, të Kodit Zgjedhor parashikohet :

“ 6. Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paafhtësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.

7. Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët

e njësive të qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.

8. Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.”

Në udhëzimin nr.1, datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të ndryshuar, neni 5 “Kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit”, parashikohet:

“1. Mjedisi i qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²;*
- b) të jetë sa më afër qendrësgjeografike të zonës së qendrës së votimit;*
- c) të jetë me ndriçim të mjaftueshëm;*
- d) të jetë në katet e para të objekteve.*

3. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:

b) zbatimin e rregullave teknike sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar për qëllim aksesimin e tyre në qendrën e votimit duke siguruar së paku që:

i. Hyrja për në qendrën e votimit të ketë kalim të vazhdueshëm horizontal dhe me pjerrësi në pjesë të nevojshme.

ii. Dyert e hyrjes për në çdo qendër votimi (hyrja kryesore dhe hyrja brenda QV-së) të lejojnë kalimin me lehtësi edhe nga personat në karrige me rrota. Pragu i derës përpara dhe pas saj të jetë në të njëjtin rrafsh me sipërfaqet e ambienteve.

4. Në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 3, të këtij neni, me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bashkitë dërgojnë informacionin për masat e marra, brenda 10 ditëve nga marrja e saj.”

Ndërtesat e institucioneve publike arsimore, kulturore dhe shëndetësore, ku përfshihen shkolla, çerdhe, kopshte, konvikte, qendra shëndetësore, qendra kulturore, janë ndërtesa ku më së shumti, por jo vetëm krijohen qendrat e votimit. Në jo pak raste gjatë ushtrimit të

veprimtarisë së tij Komisioneri ka konstatuar⁹se, ndërtesat e institucioneve publike arsimore, kulturore apo shëndetësore, nuk janë të aksesueshme, pasi nuk plotësojnë plotësojnë kriteret teknike dhe standardet e miratuara, sipas Vendimit të këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008 *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*.

Deklarata Interpretative e Rishikuar e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore mbi Pjesëmarrjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në Zgjedhjet, është miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e tij të 39-të (Venecia, 15 dhjetor 2011) dhe Komisioni i Venecias, në sesionin e tij të 89-të (Venecia, 16-17 dhjetor 2011)¹⁰. Ndër të tjera në këtë dokument parashikohet:

“Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, i miratuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në tetor 2002, parashikon se “pesë parimet që qëndrojnë në themel të trashëgimisë zgjedhore të Evropës janë universale, të barabarta, të lira, votimi i fshehtë dhe i drejtpërdrejtë” (pika I). Kodi më tej thekson në pikën I.1.1 se: “E drejta e votës universale do të thotë në parim që të gjitha qeniet njerëzore kanë të drejtë të votojnë dhe të kandidojnë në zgjedhje”.

Prandaj, personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar dhe për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike si përfaqësues të zgjedhur në baza të barabarta me qytetarët e tjerë. Pjesëmarrja e të gjithë qytetarëve në jetën politike dhe publike dhe në procesin demokratik është thelbësore për zhvillimin e shoqërive demokratike.

E drejta e votës universale

E drejta e votës universale është një parim themelor i Trashëgimisë Zgjedhore Evropiane. Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të diskriminohen në këtë drejtim, në përputhje me nenin 29 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

⁹ Vendim Nr. 201, datë 07.11.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/11/Vendim-nr.-201-date-07.11.2022-Fondacioni-Se-Bashku-kunder-Bashkise-Vore-Shkolla-Shaban-Sheshori-Diskriminim.pdf>

Vendim Nr.189, datë 10.10.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-nr.-189-date-10.10.2022-Fondacioni-Se-bashku-kunder-Bashkise-Kavaje-Diskriminim.pdf>

Vendim Nr. 182, datë 21.09.2022, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/10/Vendim-nr.-182-date-21.09.2022-Fondacioni-Se-bashku-kunder-MSHMS-Diskriminim.pdf>

Vendim Nr.6, datë 16.01.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Vendim Nr. 159, datë 10.08.2023, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Vendim Nr. 47, datë 14.02.2024, <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/03/Vendim-nr.-47-date-14.02.2024-R.H-kunder-Bashkise-Tirane-Diskriminim.pdf>

¹⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)045-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)045-e)

Procedurat dhe mjediset e votimit duhet të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike dhe të lejojnë, kur është e nevojshme, ofrimin e ndihmës në votim, duke respektuar parimin se votimi duhet të jetë individual (Kodi , pika I.4.b).

Zbatimi i parimeve të Projektimit Universal dhe pjesëmarrja direkte dhe/ose indirekte e përdoruesit në të gjitha fazat e projektimit janë mjete efektive për përmirësimin e aksesit të qendrave të votimit dhe procedurave zgjedhore për hedhjen e votës dhe për të marrë akses në informacionin për zgjedhjet.”

Në Komentin e Përgjithshëm Nr.6 (2018), “Mbi barazinë dhe mosdiskriminimin”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, përcaktohet se:

70. Përfshirja nga proceset zgjedhore dhe format e tjera të pjesëmarrjes në jetën politike janë shembuj të shpeshtë të diskriminimit bazuar në aftësinë e kufizuar. Shtetet palë duhet të synojnë:

(b) Të sigurojë që procesi zgjedhor të jetë i aksesueshëm për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë para, gjatë dhe pas zgjedhjeve;

(c) Të sigurojë përshtatje të arsyeshme për individët me aftësi të kufizuara dhe masa mbështetëse bazuar në kërkesat individuale të personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike;

Referuar Komentit të Përgjithshëm Nr.2 (2014), mbi nenin 9 “Aksesueshmëria”, të miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, parashikohet se:

“14.E drejta për aksesueshmëri për personat me aftësi të kufizuara sigurohet përmes zbatimit të rreptë të standardeve të aksesueshmërisë. Pengesat për të hyrë në objektet ekzistuese, ambjentet, mallrat dhe shërbimet e synuara ose të hapura për publikun duhet të hiqen gradualisht në një mënyrë sistematike dhe, më e rëndësishmja, të monitoruar vazhdimisht, me qëllim që të sigurohet aksesueshmëria e plotë.

23. Megjithatë aksesueshmëria është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur, siç parashikohet në nenin 19 të Konventës, dhe të marrin pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri, mohimi i aksesit në mjedisin fizik, transportin, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, dhe ndërtesat dhe shërbimet e hapura për publikun duhen parë në kontekstin e diskriminimit.....

25. Aksesueshmëria lidhet me grupet, ndërsa përshtatja e arsyeshme lidhet me individët. Kjo do të thotë se detyra për të ofruar akses është një detyrë ex ante. Prandaj, shtetet palë kanë

për detyrë të ofrojnë aksesueshmërinë përpara se të marrin kërkesa individuale për të hyrë ose përdorur një vend ose shërbim..... Standardet e aksesueshmërisë duhet të jenë të gjera dhe të standardizuara..... Në përputhje me Konventën, shtetet palë nuk lejohen të përdorin masat shtrënguese si justifikim për të shmangur sigurimin e aksesueshmërisë graduale për personat me aftësi të kufizuara. Detyrimi për të zbatuar aksesueshmërinë është i pakushtëzuar, pra subjekti i detyruar që të sigurojë aksesueshmërinë nuk mund të justifikojë mosveprimin për t'a siguruar atë, duke iu referuar barrës për sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Detyra e përshtatjes së arsyeshme, përkundrazi, ekziston vetëm nëse zbatimi nuk përbën barrë të tepruar për subjektin.

26. Detyra për të ofruar përshtatje të arsyeshëm është një detyrë ex nunc, që do të thotë se është e detyrueshme që nga momenti kur një individ me dëmtim ka nevojë për të në një situatë të caktuar..... Këtu, standardet e aksesueshmërisë mund të jenë një tregues, por mund të mos merren si urdhërues. Akomodimi i arsyeshëm mund të përdoret si një mjet për të siguruar akses për një individ me aftësi të kufizuara në një situatë të caktuar.....”.

Sipas nenit 3, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” përbën një formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është një përparësi kombëtare që kërkon politikë aktive dhe të qëndrueshme, si dhe veprime të përbashkëta të të gjithë aktorëve të përfshirë.

Niveli ende i ulët i njohjes së kuadrit ligjor ekzistues dhe i ndërgjegjësimit institucional dhe publik, krijon idenë e përgjithshme që aksesueshmëria në mjedise të identifikohet vetëm me vendosjen e një rampe në hyrje të ndërtesës, e cila në shumë raste rezulton jashtë standardeve. Më pak vëmendje i kushtohet aplikimit të elementeve të aksesueshmërisë për personat që nuk shikojnë ose kanë vështirësi në shikim.

E drejta e votës është e drejtë thelbësore dhe jo privilegj. E drejta e votës universale kërkon që të gjithë qytetarët të kenë të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në jetën politike të vendit, siç parashikohet në të drejtën kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Aksesueshmëria e plotë në çdo fazë të procesit të votimit në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jetë rregulli dhe jo përjashtimi. Aksesueshmëria është një kërkesë e pakushtëzuar dhe nuk mund të zbehet duke referuar tek “*barra disproporcionale*” pasi është parakusht për gëzimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore në pozitë të barabartë me të tjerët.

Në praktikë, aksesimi i personave me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre në baza të barabarta me ato të personat pa aftësi të kufizuara shpesh mbetet një mendim i dëshiruar që rezulton i pamjaftueshme, gjë që përkthehet në pjesëmarrje dukshëm më të ulët të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor dhe emargjinalizon më tej këtë pjesë të shoqërisë.

III. Konkluzione.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur janë miratuar akte ligjore dhe nënligjore, të cilat përmbajnë parashikime të rëndësishme, lidhur me sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara dhe përshtatjes së arsyeshme për këta individë, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrim ligjor të sigurojnë kushtet e përshtatshme në qendrat e votimit, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar, sikurse individët e tjerë që nuk ndodhen në gjendjen e tyre.

Sa më sipër, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim rregullimin e situatës dhe bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë” dhe “f”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

REKOMANDON

1. Marrjen e masave të nevojshme nga ana e të gjitha njësiteve të vetëqeverisjes vendore për Zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen në 11 Maj 2025, për të garantuar elementët e aksesueshmërisë fizike dhe për të siguruar përshtatjen e arsyeshme në qendrat e votimit, për personat me aftësi të kufizuara, duke zbatuar kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të marrin të gjitha masat e nevojshme, para dhe gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin që do të zhvillohen në 11 Maj 2025, në këto aspekte:
 - Hartimi i planeve të veprimit nga çdo njësi e vetëqeverisjes vendore, lidhur me hapat që do të ndërmerren për krijimin e infrastrukturës përkatëse në qendrat e votimit për

sigurimin e aksesueshmërisë fizike të personave me aftësi të kufizuara dhe mbi procesin e votimit për këta persona, sipas llojit të aftësisë së kufizuar;

- Të kryhet verifikimi paraprak i të gjithë qendrave të votimit nga strukturat përgjegjëse të njësive të vetëqeverisjes vendore, lidhur me plotësimin e kriterëve të aksesueshmërisë dhe votimit për personat me aftësi të kufizuara;
- Hartimi i listave të sakta të personave me aftësi të kufizuara, që janë zgjedhës, ku të evidentohet edhe lloji i aftësisë së kufizuar.
- Të mbahet dhe evidentohet si statistikë e rregullt, numri i personave me aftësi të kufizuara që kanë votuar në zgjedhje;
- Të trajtohen me prioritet të gjithë votuesit me aftësi të kufizuara në procesin e votimit;
- Të krijohet hapësira dhe lartësitë e nevojshme në dhomën e votimit dhe në kutitë e hedhjes së votës, gjatë procesit të votimit të personave me aftësi të kufizuara;

Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij Rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONER

Robert GAJDA

Punoi: K.Keta, Inspektore, DHA
Miratoi: V.Bushati, Drejtore DHA
Datë: 16.01.2025